



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Numri i lëndës: 2024:219591
Datë: 24.09.2024
Numri i dokumentit: 06201322

K.DH.SH.II.nr.1569/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Dren Rugova, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike në konfliktin administrativ të paditësit/propozuesit D...R...C... " SH.P.K, me N.U.1:, me seli: Rr."....", Nr.4, Prishtine, me pronar dhe drejtor menaxhues F.D., të cilin e përfaqeson me autorizim Avokat Shkodran Manaj, kunder të paditures/kunder-propozues Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinore dhe Infrastruktures-Qeveria e Kosoves, për shkak të anulimit të Vendimit me numër 45/2024, të datës 02.07.2024 duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës/kundër propozuese, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë,- Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.385/24 të datës 13.08.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinore dhe Infrastruktures-Qeveria e Kosoves me seli në Prishtinë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr. 385/24 të datës 13.08.2024 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

1 (5)

Me aktvendimin e ankimuar të Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ KA.nr. 385/24 të datës 13.08.2024 është aprovuar si i bazuar propozimi i paditësit/propozuesit D...R...C..." SH.P.K me seli: Rr."....", Nr.4, Prishtine, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve. Ashtu që në dispozitivi-të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë ekzekutimi i Vendimit Nr.45/2024, te dates 02.07.2024 i nxjerrë nga Agjencia e Sherbimeve te Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastruktura deri ne vendim perfundimtar te gjykatës perkitazi me kerkespadine.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka parashtruar ankesë e paditura/kundër propozuesja Agjencia e Sherbimeve te Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinore dhe Infrastruktures-Qeveria e Kosoves, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, si dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me të cilën i ka propozuar që gjykata e shkallës së dytë ankesën e të paditurës ta aprovojë si të bazuar dhe aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ, KA.nr. 385/24 të datës 13.08.2024 ta anuloj dhe çështjen t’ia kthejë të njëjtës gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

Paditësi/propozuesi, ka paraqitur përgjigje në ankesë me datë 10.09.2024, duke i propozuar gjykatës së shkallës së dytë, ta refuzon ankesën e paditurës dhe të vërtetoj Aktvendimin KA.nr. 385/24 të datës 13.08.2024, të Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti Administrativ.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, pas shqyrtimit të ankesës, shkresave të lëndës dhe pretendimeve ankimore, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit të ankimuar në kuptim të nenit 13 par. 6 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe Nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi përmes padisë së datës 08.08.2024 në këtë gjykatë ka iniciuar konfliktin administrativ me kërkesë për anulimin e vendimit me numër 45/2024 të datës 02.07.2024 i të paditurit "D...R...C..." SH.P.K me seli në Prishtinë. Me padi ka paraqitur edhe një kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të goditur, me pretendim se ekzekutimi i vendimit të goditur mund t'i shkaktojë atij dëme vështirë të riparueshëm pasi që i njëjti do të detyrohet t'a mbyll biznesin e tij dhe me këtë rast do të prodhonte efekte shumë të dëmshme, do të mbeteshin pa pune 5 (pese) punëtorë të cilët kane të themeluar marrëdhënie të punës në biznesin në fjalë, pronar i së cilës është paditësi/propozuesi si dhe do të humbet vlera e investimit të berë në punishten/objektin, ku paditësi/propozuesi e ushtron biznesin e tij, i cili investim arrin shumën rreth 700,000.00, si rrjedhojë do të ndikonte negativisht edhe në ekonominë e vendit. Po ashtu, Paditësi/propozuesi ka kredi në bankën Bankën Ekonomike, ku kesti mujor i obligimit është 2,297.58 euro dhe zbatimi i vendimit të kontestuar do t'a vë atë në pozitë tëjet të vështirë financiare, si prova i ka bashkangjitur gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transakcioneve, planin e amortizimit të kredisë, Kontratat e punës së punëtorëve. Andaj shtyrja e ekzekutimit të vendimit nuk është në kundërshtim me interesin publik, ngase nuk e pengon aspak sigurinë e operimeve, rrugën në fjalë, paditësi/propozuesi e shfrytëzon ekskluzivisht, vetëm për qellim të ushtrimit të biznesit të tij sipas pëlqimit të dhënë nga e paditura me nr. prot. 0306, dt. 19.07.2023, duke i propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar kërkesën për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar nr. 45/2024, dt. 02.07.2024 e ushtruar nga paditësi/propozuesi DAIMONT, deri në përfundim të shqyrtimit gjyqësor lidhur me kërkesëpadinë.

Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti Administrativ i Gjykatës Komerciale me aktvendimin e ankimuar KA.nr. 385/24 të datës 13.08.2024, e ka aprovuar si të bazuar propozimin e RENT A CAR" SH.P.K, për shtyrjen e ekzekutimit të vendimeve. Ashtu që në pikën II të dispozitivit të aktvendimit, gjykata e shkallës së parë e ka shtyrë ekzekutimi i Vendimit 45/2024, d.t. 02.07.2024, i të paditurës Agjencia e Sherbimeve të Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturë, me seli në Prishtinë dhe Vendimit pëlqimi 0306 i datës 19.07.2023 për dhënie të pëlqimit për qasje në rrugë nga ASHNA, pranë të paditurit, derisa gjykata të vendos me vendim përfundimtar gjyqësor lidhur me padinë e paditësit, me arsyetim se janë plotësuar kushtet ligjore 22 para. 2 lidhur me para. 6 të LKA-së për shtyrjen e ekzekutimit të vendimit të kontestuar, pasi që paditësi pretendimet e paraqitura në propozim i ka mbështetur në prova dhe argumente të qëndrueshme. Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rend të

parë në bazë të provave të lëndës, të cilat i janë bashkëngjitur kërkesë për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, erdhi në përfundim se paditësi do të detyrohej t'a mbyll biznesin e tij dhe me këtë rast do të prodhonte efekte shumë të dëmshme, do të mbeteshin pa pune 5 (pesë) punëtorë të cilët kanë të themeluar marrëdhënie të punës në biznesin në fjalë, pronar i së cilës është paditësi/propozuesi si dhe do të humbet vlera e investimit të bërë në punishten/objektin, ku paditësi/propozuesi e ushtron biznesin e tij, i cili investim arrin shumën rreth 700,000.00, si rrjedhojë do të ndikonte negativisht edhe në ekonominë e vendit. Po ashtu, paditësi/propozuesi ka kredi në bankën Bankën Ekonomike, ku kësti mujor i obligimit është 2,297.58 euro dhe zbatimi i vendimit të kontestuar do t'a vë atë në pozitë tejet të veshtirë financiare, si prova i'a ka bashkëngjitur gjendja e përgjithshme e deklarimeve dhe transakcioneve, planin e amortizimit të kredisë.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ të paraparë në nenin 22 par.2 dhe para.6 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Me këtë dispozitë juridike është paraparë që shtyrja mund të bëhet: nëse ekzekutimi i aktit administrativ do ti sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohej, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do ti sillte ndonjë dëm palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë. Sipas vlerësimit të Kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka aprovuar propozimin e paditëses për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ, përkatësisht vendimit Vendimit 45/2024, d.t. 02.07.2024 i nxjerrë nga e paditura Agjencia e Sherbimeve të Navigacionit Ajror/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapesinor dhe Infrastrukturë, me seli në Prishtinë për faktin se shtyrja eventuale e ekzekutimit nuk i sjell ndonjë dëm të madh palës kundërshtare – të paditurës. Përkundrazi, kjo Gjykatë vlerëson se lënia në fuqi e vendimit që është objekt i konfliktit administrativ do të nënkuptonte dëm eventual në anën e paditëses ngase e njëjta tani më për paditësin do ti shkaktohej dëm vështirë i riparueshem, sepse paditësi rrugen lidhese L6-Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës me rrugën magjistrale M9, për parcelën me nr. 0006-4 Zona Kadastrale Vrelle e Goleshit Lipjan, e shfrytëzon në bazë të pëlqimit me nr. prot.

0306 të datës 19.07.2023 për dhënien të pelqimit nga ASHNA, ku zhvillon aktivitetin e rregullt biznesor. Gjykata vlereson se përmes ekzekutimit të vendimit të kundërshtuar paditesit do të pamundesohet qasja në rrugë që do të ndikonte negativisht në realizimit e aktivitetit të tij biznesor, duke rrezikuar edhe mbylljen e biznesit dhe rrjedhimisht e rrezikon edhe ekzistencën e tij. Në këtë drejtim, kolegji vlerëson se mos-shtyrja eventuale e vendimit do të dëmtonte në masë paditësin, ndërkaq në anën tjetër nuk paraqet ndonjë faktor që mund të jetë në kundërshtim të interesit publik.

Duke i marrë parasysh pretendimet ankimore të paditurës, në ankesë, të cekura më lartë ndaj aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë, Kolegji vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe të pamjaftueshme për tu aprovuar ankesa. Pretendimet e tjera, Dhoma e Shkallës së Dytë i vlerësoi si të pabaza pasi që krahas përshkrimit të fakteve të çështjes nuk kanë në përmbajtje ndonjë arsye ligjore dhe bindëse për tu vendosur ndryshe, po ashtu pretendimet e tilla do të shqyrtohet me rastin e vendosjes në çështje meritore.

Andaj, kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, pranon në tërësi si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e tillë të gjykatës së shkallës së parë, nga se edhe sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, në rastin konkret janë plotësuar në mënyrë kumulative kushtet për shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ siç është paraparë në nenin 22 par.2 të Ligjit për Konfliktet Administrative.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 209 par.1 nën (b) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.1569/24, data 23.09.2024

**Kryetarja e kolegjit
Franciska Zhitija Ymeri**